



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

Psh. nr. 633/22
635/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej Vedat Poterqoi - Kryetar, Kimete Gashi - Referues, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik (OE) "Progobal Sh.P.K"- Prishtinë me nr protokolli 633/22 si dhe ankesa e OE "Komtel Project Engineering Sh.P.K" me numër protokolli 635/22, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit: "Furnizim me Automjete [Kamionë] Zjarrfikës Sulmues për BZ në Mitrovicë " me nr. të prokurimit: 642-22-9185-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Kuvendi Komunal Mitrovicë, më datën: 22.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik "Progobal", e ushtruar me 08. 11. 2022, me numër 633/22, ndërsaq **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE ankues "Komtel Project Engineering Sh.P.K" e parashtruar në OSHP me datën 08. 11. 2022, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me Automjete [Kamionë] Zjarrfikës Sulmues për BZ në Mitrovicë" me nr. të prokurimit: 642-22-9185-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Kuvendi Komunal Mitrovicë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK).

Anulohet, njoftimi i AK i datës 25.10.2022, për dhënie të kontratës për aktivitetin e lartcekur të prokurimit, dhe lënda kthehet në **rivlerësim**.

Konfiskohet shuma e mjeteve të deponuara në emër të tarifës për ankesë, të operatorit ekonomik "Progobal" në kuptim të nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP-së 01/2020, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Meqenëse ankesa e OE "Komtel Project Engineering Sh.P.K", aprovohet si e bazuar, i behët kthimi i depozitës së paguar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik

ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Kuvendi Komunal Mitrovicë nga cilësia e saj si AK, me 05.09.2022, ka publikuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) Njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Automjete [Kamionë] Zjarrfikës Sulmues për BZ në Mitrovicë” me nr. të prokurimit: 642-22-9185-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Kuvendi Komunal Mitrovicë, me ç ‘rast elementet qenësore të prokurimit janë precizuar si në vijim: Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 70,000.00 €. Hapja e ofertave e planifikuar me 20. 09. 2022.

Në fakt, me 25 tetor 2022, AK (me të dhëna si më sipër), ka publikuar Njoftimin B58 për dhënie të kontratës, e cila i është dhënë OE “Agri Bau” SH.P.K - Prishtinë”, ndërsa OE-të ankues janë njoftuar me Letër standarde për tenderuesin e eliminuar.

Kundër këtij vendimi, me datën 08. 11. 2022, në OSHP fillimisht ka parashtruar ankesë OE “Progobal” me nr. 633/22 (Nr. Protokolli), dhe me po të njëjtën datë, ankesë ka parashtruar edhe OE “Komtel Project Engineering Sh.P.K” nr. 635/22 (Nr. Protokolli).

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 21.11.2022, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa e OE ankues “Progobal” të refuzohet si e pabazuar;
- Ankesa e OE ankues “Komtel Project Engineering Sh.P.K” të aprovohet si pjesërisht e bazuar;
- Vendimi i atakuar i AK për dhënie të kontratës të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim

Raporti i ekspertizës i cituar si më sipër, është pranuar nga të gjitha palët.

Në fakt, ankuesi “Progobal”, ka parashtruar ankesë kundër Njoftimit për dhënie të kontratës (datë si më sipër) duke pohuar mes tjerash se: (a) gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit AK ka vepruar në kundërshtim Neni 1 të LPP-së, nenin 6 të LPP-së, nenin 7 të LPP-së, nenin 59 i LPP-së, si dhe nenin 60 dhe 72 i LPP-së, dhe, (b) Me datë 25.10.2022 AK ka publikuar dokumentin B58 Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues duke bashkangjitur letrën standarde me të cilin janë eliminuar me arsyetimin se: “Ju si OE Progobal SH.P.K nuk keni ofruar as KATALOG as Specifikime teknike të Kamionit dhe duke u bazuar në Neni 28 LPP-se thuhet citoj: Mungon Specifikacioni Teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu-Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm dhe OE në fjale eliminohet nga kjo procedure e Prokurimit”. Sipas OE me Vendimin e AK të datës 25.10.2022 dhe letrën standarde mbi eliminim me të cilin AK na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit shihet qartë se AK respektivisht komisioni i vlerësimit nuk e ka zbatuar në tërësi kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit respektivisht piken 3.1 të FDT-së, ndërsa OE në ankesë pretendon se me rastin e ofertimit kanë bashkangjitur deklaratën lidhur me specifikacionin teknik me të cilën kemi deklaruar se oferta është në përputhje të plote me Aneksin 1- specifikimet e teknike të detyrueshme të DT.

Ndërkaq ankues “Komtel Project Engineering Sh.P.K” pretendon se janë shkelur neni 1 i LPP-së, 7, 28, 59 i LPP-së si dhe nenet 26 dhe 41 të RRUOP-së. OE ndër shumë pika ankimore ka theksuar se nuk pajtohet me përgjigjen e dhënë nga Autoriteti Kontraktues për faktin që kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga ta nuk ishte një kërkesë në të cilën vetëm janë përshkruar nene nga LPP por ishte një kërkesë e cila secilën shkelje e shoqëron me Nenin e shkelur. “Autoriteti Kontraktues në fakt ka bërë shkelje të një pas njëshme në këtë aktivitet të prokurimit që nga fillimi i vlerësimit të ofertave dhënien e njoftimit mbi vendimin e deri në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim”, ka theksuar OE.

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherit duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli konstatoi në vijim se:

Përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër, AK ka zbatuar procedurë të hapur të tenderimit, me kriteret si në vijim: procedurë e hapur; kontratë – furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: Totali–70,000.00 €.

Pretendimet kryesore mbi bazën e të cilave është ushtruar ankesa OE “Progobal” konsistojnë në faktin se është eliminuar se nuk ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit mbi mundësitë teknike dhe profesionale. Paneli shqyrtues sqaron se sa i përket arsyes së eliminimit tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, kërkesa 3- Prezantimi i produkteve të ofruara me katalogë broshura, si dëshmi dokumentare është kërkuar: “*Operatori Ekonomik duhet të paraqesë tek AK katalogë broshura për produkte të ofruar duke e nënvizuar produktin e ofruar, së bashku me një përshkrim të karakteristikave të produkteve siç kërkohet në specifikimet*”

teknike te Detyrueshme-Anexi 1”, Paneli shqyrtues vlerëson se arsyetimi i eliminimit është i qëndrueshëm dhe i bazuar pasi qe për gjithë ofertuesit është kërkuar qe te dorëzojnë një katalog me përshkrim te karakteristikave te produktit te ofruar. Ne dosjen e tenderit te dorëzuar nga OE ne fjalë ne asnjë dokument nuk është specifikuar se me çfarë Lloji te automjetit ka ofruar, andaj dorëzimi i vetëm një deklaratë nga ana e OE ankues: “Deklarojmë se oferta jone është ne përputhje te plote me Aneksi 1 - Specifikimet Teknike te detyrueshme te DT” për panelin shqyrtues nuk konsiderohet e mjaftueshme për mbulimin e kërkesës.

OE ankues pretendon se me rekomandimin për kontratë të OE "Agri Bau" sh.p.k, AK ka vepruar në kundërshtim me kriterin “çmimi më i lirë” sepse OE i rekomanduar për kontratë, ka dorëzuar ofertë me vlerë financiare prej: 48,899.20 €, te cilën nëse e krahasojmë me ofertën e tyre në vlerë prej 34,864.36 € është më e shtrenjtë në vlerë prej 14,034.84 €. Paneli shqyrtues sqaron se sa i përket Kriteret e Dhënies AK KK Mitrovica ne nenin 31.1 te FDT-ës ne dosjen e tenderit për aktivitetin ne fjalë e ka përzgjedhur kriterin “Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët”. Ne pikën 4 te nenit 59 te LPP-se thuhet: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen a vepruar në kundërshtim edhe me paragrafin 1.1 te pikës 1 te nenit 60 të LPP-së ku qarte përcaktohet se “Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët”. Pasi qe oferta e OE ankues nuk është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit nga ana AK-se për mendimin e ekspertit shqyrtues pretendimi ankimor i Ankuesit është i pa bazuar. Paneli shqyrtues vlerëson se OE ankues, në asnjë pikë të ankesës nuk e ka specifikuar/ theksuar se pse i njëjti është i përgjegjshëm por e gjithë ankesa ka të bëjë më OE të rekomanduar për dhënie të kontratës, pa e theksuar se a është apo jo i njëjti i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues poashtu shqyrtoj dhe analizoj pretendimet ankimore të OE ankues “Komtel Project Engineering Sh.P.K”.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës është operator ekonomik i papërgjegjshëm dhe i cili nuk ka respektuar kërkesat e FDT-Seksioni II-Fleta e te dhënave te tenderit, kërkesa për Deklarate te Specifikave, paneli shqyrtues sqaron se AK ka përdorur formularin standard te miratuar nga KRPP-ja B15 Dosja e Tenderit - Furnizim - Procedura e hapur, ku ne bazë te këtij formulari tek Seksioni II Fleta e të dhënave të tenderit (FTD) përkatësisht pika 3.1 thuhet: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit, paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues sqaron se AK ka përdorur formularin standard te miratuar nga KRPP-ja B15 Dosja e Tenderit - Furnizim - Procedura e hapur, të cekur si në pretendimin ankimor. AK nuk ka përcaktuar apo veçuar ndonjë deklaratë specifike lidhur me specifikimet teknike te Aneksit 1, forma e tille është forme standarde e pamodifikuar e dosjes se tenderit pra e njëjta është shabllon. AK ka kërkuar qe “Operatori

Ekonomik duhet të paraqesë tek AK katalogë broshura për produkte të ofruar duke e nënvizuar produktin e ofruar, së bashku me një përshkrim të karakteristikave të produkteve siç kërkohet në specifikimet teknike të Detyrueshme-Anexi 1”, andaj ky pretendim ankimor është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të dytë të OE ankues, paneli shqyrtues sqaron se AK në Aneksin 1 të dosjes së tenderit ka prezantuar specifikimin teknik për kamionin e kërkuar, në të cilin specifikim janë të specifikuara kërkesat që duhet të plotësoj automjeti i ofruar nga ana e OE ofertues. Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë nga ana e KK Mitrovicë ka dorëzuar specifikimin teknik për automjetin e ofruar i cili nuk i përmban disa nga kërkesat e specifikimit teknik që janë kërkuar. Në specifikimin teknik të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë është i specifikuar tipi i automjetit por nuk është specifikuar se me çfarë modeli ka ofruar po ashtu nuk ka prezantuar të dhëna për numrin e rrotullimeve të motorit. Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në specifikimin teknik të dorëzuar nuk e ka të specifikuar se automjeti i ofruar a i plotëson edhe kërkesat e specifikimit teknik që kanë të bëjnë me Pompa për zjarrfikëse.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësit e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesat në këtë rast.

- Përfundim -

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 59 të Ligjit të cituar sipas të cilit ekzaminimi dhe krahasimi i tenderit duhet të bëhet konform këtij ligji, andaj duke u bazuar në atë se asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër, Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat POTERQOI



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerçiale- Dhoma e shkalles se pare, departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- KK Mitrovice

1x1 OE-ve ankues

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.